



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 01, datë 01.08.2023

PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 01, DATË 28.12.2020 TË KËSHILLIT
KOMBËTATË TERRITORIT "PËR MIRATIMIN E PLANEVE TË DETAJUARA
PËR ZONAT E RËNDËSISË KOMBËTARE NË BREGDET "BAKS-RRJOLL DHE
RANA E HEDHUN-PORT SHËNGJIN"

Në mbështetje të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, të Vendimit Nr. 6, datë 16.10.2017 të KKT-së "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Lezhë", i ndryshuar, me propozim të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Në Vendimin nr. 01, datë 28.12.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit "*Për miratimin e planeve të detajuara për zonat e rëndësisë kombëtare në bregdet "Baks-Rrjoll dhe Rana e Hedhun-Port Shëngjin"*" të shfuqizohet Plani i Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare në Bregdet: Rana e Hedhun, si dhe dokumentet e mëposhtëm:
 - *Plani i Detajuar i Zhvillimit, Rana e Hedhun;*
 - *Rregullorja e Detajuar e Planit, Rana e Hedhun;*
 - *Hartat shoqëruese të Planit të Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare në Bregdet: Rana e Hedhun.*
2. Ngarkohen Bashkia Lezhë dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.

3. Ngarkohen Bashkia Lezhë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

